

Shkelzen (Misin) Dobra

(3.10.1978, shqiptar nga Krysheci/Kruševac, komuna Skënderajt/Srbica, pjesëtar i UÇK-së)

Shkelzeni me prindërit dhe motrat e kishte braktisur Kruševën/Kruševac më 20.09.1998, dhe u vendosën në Duboc/Dubovac, te daja, i cili i kishte strehuar rreth 100 refugjatë nga fshatrat përreth. Në mëngjesin e datës 22.09.1998, forcat serbe filluan që ta bombardojnë fshatin. Popullata dhe refugjatët u strehuan në bjeshkëta e *Çiçavicës/Çiçavica*, në pyllin përmbi fshatin **Duboc/Dubovac**. Ata i shihnin ushtarët serb, duke i djegur shtëpitë e fshatit. Rreth orës 13:00, më **23.09.1998**, në pyll kishin hyrë ushtarët serb. Shkelzeni dhe disa të rinj kishin ikur në brendësi të pyllit, por pas tërheqjes së forcave serbe, ata u kthyen në vendin ku ende qëndronin banorët e Dubocit/Dubovac. Familjes së Shkelzenit i thanë se ai në një çast ishte ndarë prej tyre dhe ata nuk dinin më asgjë për të. Familjarët një kohë të gjatë nuk dinin asgjë për fatin e Shkelzenit. Më 27.07.2005, familjarët mësuuan se mbetjet mortore të tij janë gjetur në pjesën veriore të Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. Mbetjet mortore të tij i kishin marr nga Instituti për mjekësinë ligjore në Rahovec/Orahovac dhe i varrosën në varrezat e fshatit Kruševë/Kruševac.

Burimet: deklarata V.G, FDH-13706; OMPE, *Mbetjet.*, FDH-15297; J. Martinsen, *Regjistr.*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816.

Enver (Halit) Haliti

(5.03.1956, shqiptar nga Luboveci/Ljubovac, komuna e Skënderajt/Srbica, profesor, tre fëmijë)

Enveri kishte punuar si arsimtar i gjuhës shqipe në Shkollën e Mesme *Silvira Tomazini* në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Çdo ditë udhëtonte për në punë nga fshati i vet të Lubavecit/Ljubovac. Më 20.09.1998, forcat serbe e kishin rrethuar fshatin Lubavec/Ljubovac, Enveri me familje të vet gjendej në shtëpi. Ata, së bashku me banorët e tjerë të fshatit, në mesin e tyre edhe familja e vëllait të Enverit, kaluan në Qirez/Čirez

[Skënderaj/Srbica]. Atje i kaluan dy ditë dhe më **23.09.1998**, u nisën që të ktheheshin në fshat. U nisën me traktorë, në rimorkiot e të cilëve kishin vendosur edhe njerëz të tjerë. Në udhëkryqin në *Mëhallën Shalaku* në **Duboc/Dubovac**, u ndaluan nga pjesëtarët e forcave serbe. Ata u urdhëruan refugjatëve që të zbritnin nga traktori dhe i çuan në livadhin e afërt. Enverin dhe meshkujt e tjerë i kishin ndarë nga gratë dhe fëmijët. I mbanin kështu derisa nuk erdhi një *Pinzgauer* nga i cili dolën tre pjesëtarë të maskuar të forcave policore. Ata iu drejtuan Enverit në gjuhën shqipe: „Ku je Enver, ne po të kërkojmë nëpër qiell, kurse ti je në tokë?“ Më pas njëri e dërgoi deri te traktori, duke e rrahur me kondak. Gratë dhe fëmijët qanin, kurse babai i Enverit i pyeti ku po e dërgonin djalin e tij. Ushtarët e maskuar i kthyen se do ta kthejnë pasi ta merrnin në pyetje, ndërsa të tjerët i urdhëruan që të vazhdonin udhën. Kjo ishte hera e fundit kur familjarët e kishin parë Enverin të gjallë. Pas tri ditësh, më 26.09.1998, në udhëkryqin ku pjesëtarët e forcave serbe e kishin ndal Enverin, Mujë Kabashi e gjeti trupin e tij të pajetë. E kishin vrrarë me një plumb në kokë. Familjarët e varrosën Enverin po atë ditë në varrezat e fshatit Lubavec/Ljubovac.

Burimi: deklarata O.H, FDH-20364.

Hysen (Murat) Hajrizi

(9.08.1931, shqiptar nga Balinca/Balince, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, bujk, nëntë fëmijë)

Komanda e Korpusit të Prishtinës së Ushtrisë së Jugosllavisë, më 19.09.1998, kishte lëshuar urdhër për mbështetjen e forcave të MPB-së në luftimin e forcave të UÇK-së, në shpatet e bjeshkës së *Çiçavicës/Çiçavica*, duke përfshirë edhe fshatin Balincë/Balince. Të nesërmen, më 20.09.1998, herët në mëngjes, forcat serbe i ishin afruar fshatit Balincë/Balince. Familja e madhe e Hysenit, së bashku me banorët e tjerë, e kishte braktisur fshatin, ndërsa ai ndenji në fshat. Po atë ditë, rreth fshatit filluan luftimet në mes të forcave serbe dhe të UÇK-së. I biri i Hysenit,